

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË.

Nr. 184 Prot.

Tiranë, më 01.032016

VENDIM Nr. 1, datë 29.02.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "**Për Trashëgiminë Kulturore**" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, të datës 29.02.2016, pasi shqyrtoi Relacionin e rivlerësimit të 7 siteve të cilësuar me potencial arkeologjik nga Vëzhgimi intensiv sipërfaqësor, i miratuar me vendimin Nr. 189 të KKA, datë 17.04.2012 dhe propozimin për konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike në këto site, në kuadër të **projektit të HEC-ve në Kaskadën e lumit Devoll, subjekti "Devoll Hydropower" sh. a.**, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" Sh.P.K.,

VENDOSI:

- I. Të miratojë Relacionin e rivlerësimit të 7 siteve të cilësuar me potencial arkeologjik nga Vëzhgimi intensiv sipërfaqësor, i miratuar me vendimin Nr. 189 të KKA, datë 17.04.2012 dhe propozimin për konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së sondazheve arkeologjike në këto site, në kuadër të **projektit të HEC-ve në Kaskadën e lumit Devoll, subjekti "Devoll Hydropower" sh. a.**, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" Sh.P.K.
- II. Subjekti "Devoll Hydropower" sh.a për kryerjen e sondazheve në sitet 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, sipas konceptit dhe metodologjisë të përcaktuar në relacionin e rivlerësimit të tyre, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" Sh.P.K., duhet të lidhë më parë kontratë tre palëshe me shoqërinë e licencuar në arkeologji dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikqyrë këtë shoqëri. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
- III. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTER



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO